

REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCES SVERBAL

NGA MBLEDHJA E -XI- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 26 DHJETOR 2019

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:20.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri:

Abdullah Vojvoda, Agim Bregaj, Agron Perçuku, Ali Januzi, Arta Ymeri, Bahrije Ademi Murati, Basri Menxhiqi, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Fitim Halili, Fatmire Saraçi, Faton Shabani, Gresa Muli, Habibe Gërxhaliu, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Hajriz Mustafa, Lorik Maxhuni, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli-Latif, Miljan Bojković, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Sadije Bajgora, Safet Idrizi, Selim Rustemi Shkëlzen Feka, Teuta Aruci Shartari dhe Ymer Haradinaj.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe nënkyetari i komunës -z. Besim Muzaqi, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Munguan: Hysni Gërguri, Gentiana Rama, Rrezarta Krasniqi, Fjolla Ujkani dhe Shpëtim Zhegrova.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se në sallë janë prezent 30 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe përmarrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-lidhur me rregulloren për orarin e punës të bizneseve në Komunën e Vushtrrisë, njoftoi se komuna e ka të aprovuar një rregullore të tillë e cila është në fuqi. Andaj një rregullore e tillë nuk ka pasur nevojë që të prezantohet si draft, mirëpo kjo është dashur të bëhet duke proceduar një propozim-vendim për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores aktuale, për të cilën ai pajtohet se ka nevojë që të bëhet një riorganizimi sa i përket orarit të punës të organizatave afariste që operojnë në Komunën e Vushtrrisë.

Albanez Tahiraj, zyrtar ligjor-tha se plotësim-ndryshimi i një akti në këtë rast i rregullores në fjalë duhet të bëhet me aktin e njëjtë, e që më pastaj duhet të ndiqet procedura e njëjtë e diskutimit publik sikurse në rastin e hartimit nga fillimi të një akti komunal.

Në fund të diskutimeve lidhur me rendin e ditës kuvendit pas votimit me vota “unanime” aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, mbajtur më 27 nëntor 2019;
2. Shqyrtimi i peticionit të lagjes urbane “Kalaja” në Vushtrri;
3. Shqyrtimi i Draft-Planit të Punës i Kuvendit të Komunës të Vushtrrisë për vitin 2020;
4. Shqyrtimi i Draft-Planit të Punës i kryetarit – qeverisë komunale për vitin 2020;
5. Shqyrtimi i Propozim–vendimit për formim të komisionit vlerësues për zbatim të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;
6. Shqyrtimi i Propozim–vendimit për formim të komisionit të ankesave në procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;
7. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen sociale në Komunën e Vushtrrisë;
8. Shqyrtimi i Draft-Planit Komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar 2019 – 2022 (**shqyrtimi i parë**);
9. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për përkrahjen e fermerëve në bujqësi dhe bizneseve në sektorin privat (**shqyrtimi i parë**);
10. Shqyrtimi i Raportit të sistemit të menaxhimit të performancës së komunës në ofrimin e shërbimeve për vitin 2018;
11. Shqyrtimi i Projekt-Planit i zhvillimit Institucional të Kujdesit Parësor Shëndetësor 2020-2024;
12. Të ndryshme.
 - a). Shqyrtimi i Draft-planit të punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2020;
 - b). Shqyrtimi i Draft-planit për transparencë 2019-2022;
 - c). Shqyrtimi i Draft-Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës së Bizneseve në Komunën e Vushtrrisë; me numër të protokollit 01-272/10 e datës 30.12.2010;
 - ç). Shqyrtimi i memorandumit të mirëkuptimit mes Komunës së Vushtrrisë dhe organizatës Gremin;
 - d). Shqyrtimi i Propozim–vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, për ofrimin e shërbimeve me auto-marimangë.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, mbajtur më 27 nëntor 2019;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanimë aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit, e datës 27 nëntor 2019.

2. Shqyrtimi i peticionit të lagjes urbane “Kalaja” në Vushtrri;

Ismajl Haziri, kryetar i lagjes urbane “Kalaja”-paraqiti sqarime lidhur me problematikën e qasjes së qytetarëve të kësaj lagje në rrugën magjistrale Mitrovicë-Prishtinë, dhe arsyetoj peticionin e parashtruar nga ana e këtyre banorëve, lidhur me ndërtimin e vendkalimeve për këmbësorët dhe automjetet në këtë rrugë në shtrirjen e saj përgjatë lagjes “Kalaja”. Pastaj adresoi kritikë për autoritetet komunale për gabimet e bëra gjatë hartimit të projektit për ndërtimin e kësaj, rruge për siç tha se hartimi është bërë pa zhvilluar diskutim publik dhe pa i pyetur fare banoret lokal të lagjes urbane “Kalaja”. Në fund ai kërkoi nga kuvendi që të merret seriozisht me këtë

problem dhe nëse është e nevojshme të bëhet revidimi i këtij projekti ashtu që të mundësohet ndërtimi i vendkalimeve për këmbësor dhe automjete që të kemi qaje më të lehtë në rrugën magjistrale për banorët e kësaj lagje.

Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit –në emër të grupit kuvendar të LVV-së e përkrahin kërkeshën e bërë nga ana e këtyre banorëve. Në këtë kontekst vlerësoi se si grup e kanë analizuar këtë petition, dhe kanë nxjerr konkluzionin se kërkesa e këtyre banorëve është e arsyeshme. Tutej shtoi se prioritet për ta por edhe për të gjitha strukturat tjera duhet të jetë ruajtja e jetës së njeriut, për faktin se nga gjendja në teren shihet se do të ketë rrezik për nxënësit tanë gjatë kalimit të asaj rruge. Në këtë relacion mendon se është e domosdoshme vendosja e një semafori tek rruga “2 maji” pasi që është thënë se aty nuk mund të ketë nënkalim. Pastaj tek vendi i quajtur tek ndërmarrja “Extra” në atë vend në mund të bëhet ndërtohet një nënkalim, mandej tek rruga në drejtim të fshatit Begaj duhet të bëhet diçka pasi që në atë pjesë kemi frekuentim të madh të qytetarëve e sidomos nxënësit janë të rrezikuar, andaj në këtë vend duhet që ekspertet të jalin mendim e tyre që aty të vendoset ndonjë semafor apo ndonjë zgjidhje tjetër. Tutej problemet shfaqen edhe tek rruga “Shote Galica”, ku edhe në këtë pjesë gravitojnë një numër i madh i qytetarëve, ku edhe këtu frekuentojnë shumë nxënës, në këtë vend kishte me qenë mirë të ndërtohet ndonjë nënkalim, e nëse kjo është e pamundur, atëherë të bëhet një mbikalim edhe pse ky do të ishte pak i shfrytëzueshëm.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – në emër të grupit kuvendar të PDK-së, parimisht e mbështhesin petitionin e banorëve të kësaj lagje, dhe solidarizohen me shqetësimin e banorëve të kësaj zone-lagje. Pastaj për opinion ai sqaroi se hartimi i projektit për zgjerimin e rrugës magjistrale katër korsi në atë zonë të qytetit është bërë nga ana e komunës. Pastaj deklaroi me përgjegjësi të plotë para qytetarëve se projekti i hartuar nga Komuna e Vushtrrisë lidhur me këtë rrugë është ndryshtë nga ai i cili është duke u zbatuar aktualisht, për faktin se nuk ka pasur ndërprerje në mes të korsive, ky projekt është hartuar në atë formë që ka pasur për qëllim ruajtjen e interesit të bizneseve dhe që lëvizja e qytetarëve të jetë më e lirë dhe më e qasshme për banorët e kësaj zone. Mirëpo pasi që zbatuesi i këtij projekti është Ministria e Infrastrukturës, kur është dorëzuar projekti në këtë ministri kjo e fundit e ka ndryshuar këtë projekt, lidhur me këtë komuna ka kërkuar sqarime dhe ka mbajtur takime me zyrtaret e ministrisë, të cilët kanë deklaruar se ndërtimi i rrugës duhet të bëhet sipas standardeve profesionale, duke i vendosur ndarjet fizike mes korsive. Andaj petitioni i këtyre banorëve është i arsyeshëm dhe ata e përkrahin në mënyrë morale, mirëpo implementimi i këtij projekti dhe gjitha kërkeshat janë kompetencë ekskluzive e ministrisë. Në fund tha se me këtë projekt janë dëmtuar edhe disa biznese, por e vërteta është që ministria e ka bërë këtë rrugë sipas standardeve profesionale rrugore dhe pas përfundimit të kësaj rruge kjo rrugë do të marr kodin e rrugës kombëtare dhe ndërkombëtare.

Shkëlzen Feka, anëtar i kuvendit –tha se i përkrah shqetësimet e këtyre banorëve të adresuar përmes këtij petitioni, dhe kërkoi që për këtë çështje të jepen sqarime shtesë duke u publikuar shkresat e kësaj lënde të komunikimit me ministrinë e linjës, dhe kështu të shikohet mundësia se çfarë mund të bëhet në zgjidhjen e këtij problemi.

Ismajl Haziri, kryetar i lagjes urbane “Kalaja”-njoftoi se në konsultimet që ka pasur me ministrin Pal Lekaj, është informuar se projekti për ndërtimin e kësaj rruge është hartuar nga Komuna e Vushtrrisë ndërsa financimi i ndërtimit të kësaj rruge është bërë nga Ministria e Infrastrukturës.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit –përsëriti me përgjegjësi të plotës se ky projekt është hartuar nga Komuna e Vushtrrisë, i cili është paraparë që të mos ketë ndërprerje në mes korsive, pas kësaj ka ndodhur revidimi i këtij projekti nga ana e ministrisë, dhe më pas janë shpallur procedurat e

prokurimit, kjo mund të vërtetohet nëse kërkon dokumentacioni i dosjes në Drejtorinë e Urbanizmit.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” aprovoi këtë:

REKOMANDIM

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë e mbështet peticionin e lagjes “Kalaja” në Vushtrri, lidhur me caktimin e vendkalimeve për këmbësor dhe automjete në rrugën magjistrale Mitrovicë-Prishtinë, dhe kërkon nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, që në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit, të bëjë revidimin e projektit për ndërtimin e rrugës magjistrale Mitrovicë-Prishtinë, përgjatë kufizimit të lagjes “Kalaja”, në ç’ rast do të mundësohej ndërtimi i vendkalimeve për këmbësor dhe automjete në rrugën e sipërcetur.

ARSYETIM

Banorët e lagjes “Kalaja” në Vushtrri, kanë parashtruar kërkesa dhe peticione në vazhdimësi, në ç’ rast është adresuar shqetësimi i tyre për shkaktimin e problemeve të ndryshme, me rastin e ndërtimit të rrugës magjistrale Mitrovicë-Prishtinë, si rezultat i mungesës së vendkalimeve dhe kyqjeve për këmbësor dhe automjete, ashtu që është vështirësuar qasja e qytetarëve të kësaj lagjeje në rrugën magjistrale. Si shkak i projektimit të gabuar të kësaj rruge janë shkaktuar pasoja të rënda për qytetaret dhe biznese e kësaj pjese. Andaj Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë i mbështet kërkesat e qytetarëve të kësaj lagje dhe kërkon që të veprohet shpejt dhe me kompetencë që të mundësohet revidimi i këtij projekti.

3. Shqyrtimi i Draft-Planit të Punës i Kuvendit të Komunës të Vushtrrisë për vitin 2020;

Gresa Muli, anëtar e kuvendit-propozoi që në draft-planin e punës të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2020, në muajin janar të futet propozim-vendimi për ndryshimin e dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e bursave dhe shpërblimeve për nxënës, këtë propozim ajo e arsyetoj me faktin se duke qenë për dy vite radhazi anëtar e komisionit për ndarjen e bursave, si komision kanë hasur në vështirësi për ndarjen e bursave në mënyrë të drejt dhe meritore. Ajo këtë kërkesë e ka bërë disa herë në kuvend, duke ju adresuar Drejtorisë së Arsimit por që fatkeqësisht deri tani nga kjo e fundit nuk është ndërmair asgjë.

Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit –propozoi që muajin janar të futet Draft-rregullorja për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit –propozoi që në muajin shkurt në Planin e Punës të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2020 të futet Informata për ofrimin e njohurive për Implementimin e Rregullores Komunale Kundër Korruptionit. Kjo rregullore është miratuar nga kuvendi i komunës, por asnjëherë nuk janë ofruar informata për zbatimin e saj praktik, se a ka mekanizma të mjaftueshme për luftimin e dukurive negative, a ka pasur iniciativë rasti, për korruption nëse po sa raste kanë qenë e të ngjashme.

Faton Shabani, anëtar i kuvendit –propozoi që të futet në planë të punës Draft-rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Dekorata, pasi gjatë këtij viti kanë dështuar përpjekjet

për hartimin e kësaj irregulloreje, andaj propozoi që kjo irregullore të procedohet në muajin shkurt 2020.

Ermal Lahu, anëtar i kuvendit –propozoi që në muajin shkurt të futet si pikë e rendit të ditës informatë për gjendje shëndetësore dhe sociale.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” aprovoi Planin e Punës të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2020, me propozimet e dhëna nga anëtarët e kuvendit.

4. Shqyrtimi i Draft-Planit të Punës i kryetarit – qeverisë komunale për vitin 2020;

Gresa Muli, anëtare e kuvendit-tha se kryetari i komunës është dashur të jetë sot prezent në këtë mbledhje të kuvendit për ta prezantuar këtë plan.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi, me vota “unanime” aprovoi Planin Punës të kryetarit – qeverisë komunale për vitin 2020.

5. Shqyrtimi i Propozim–vendimit për formim të komisionit vlerësues për zbatim të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;

Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së-paraqiti sqarime lidhur me propozim-vendimin në fjalë, duke interpretuar dispozitat ligjore të Ligjit për Dhënien e Pronës në Shfrytëzim i cili ka hyr tani në fuqi së fundmi, si dhe dha sqarime sa i përket irregullimit të materies si themelimit të këtij komisioni. Sipas dispozitave të ligjit të ri për dhënien e pronës në shfrytëzim për secilën pronë komunale e cila jepet në shfrytëzim themelohet komision i posaçëm.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit –vlerësoi se për themelimin e këtyre komisioneve komunale, duhet të ketë rregulla dhe parime, ti cilat fatmirësish ligji i ka parapa e të cilat në të kaluarën nuk janë respektuar. Themelimi i këtyre komisioneve duhet të jetë gjithëpërfshirës duke përfshirë anëtarë nga pozita dhe opozita. Kryesuesi i kuvendit duhet të jetë në nivel të përgjegjësisë dhe detyrës në këtë aspekt ose në të kundërtën ata si grup kuvendar nuk do të votojnë këto pika. Majorizimi i këtyre komisioneve ka për qëllim fshehjen e gjérave dhe karakterizohet me mungesë të transparencës, si grup kuvendar janë që të ketë përfaqësim të të gjithë spektrit politik të komunës. Ai propozoi Kushtrim Hysenin për anëtar të komisionit për vlerësimin e pronës.

Bahrije Ademi - Murati, anëtare e kuvendit-propozoi Mehdi Bejtullahun, për anëtar të Komisionit vlerësues për zbatim të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

Shkëlzen Feka, anëtar i kuvendit –në emër të grupit kuvendar të LDK-së propozoi Agron Përçukun për anëtar të komisionit të sipërcekur.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 16 vota “për”, 9 vota “kundër” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim formohet Komisioni Vlerësues për zbatim të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, në këtë përbërje:

- 1.1 Agron Përçuku, anëtar i Kuvendit;
- 1.2 Mehdi Bejtullahu, anëtar i Kuvendit;

1.3 Adnan Lahu, ekzekutivi i komunës;
1.4 Miran Halili, ekzekutivi i komunës;
1.5 Besmir Ahmeti, shoqëria civile.

2. Anëtarët e Komisionit Vlerësues në takimin e parë, me shumicë votash, zgjedhin kryesuesin i cili e kryeson komisionin.

3. Komisionit Vlerësues ka mandat për shqyrtim të ofertave për pronën/at e përfshira në vetëm një vendim paraprak të kuvendit të komunës.

4. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit:

4.1 Komisionit Vlerësues zbaton procedurat e ankandit publik për pronën e paluajtshme të komunës e cila jepet në shfrytëzim që nënkupton:

4.1.1 Njoftimin publik i cili zgjatë 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit,

4.1.2 Njoftimi publik publikohet në faqen zyrtare të komunës, në tabelën e shpalljeve të komunës, në vedin ku gjendet prona e komunës e cila jepet në shfrytëzim dhe së paku në njëren nga mediat e shkruara dhe elektronike.

4.1.3 Njoftimi duhet të përmbaj të dhënat kadastrale të pronës, lokacionin, përshkrimin e pronës, kohëzgjatjen e shfrytëzimit, formën e konkurrimit, arsyeshmërinë e interesit publik, çmimin fillestar, kërkesat për pjesëmarrje në konkurrim, kohën dhe vedin ku mbahet ankandi dhe hapja e ofertave.

4.2 Pas pranimit të ofertave Komisioni Vlerësues bën vlerësimin e tyre në përputhje me kushtet e përcaktuara në njoftimin publik.

4.3 Komisioni Vlerësues përzgjedh përfituesin brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e mbylljes së njoftimit publik në rastet e vlerësimit të ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër, ndërsa brenda 15 ditësh për rastet e dhënieve në shfrytëzim afatgjatë.

4.4 Njoftimin për përzgjedhjen e ofertave komisioni e publikon në faqen zyrtare të komunës si dhe të njëjtin ju dërgon palëve të përfshira në proces.

4.5 Komisioni Vlerësues pas përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesave për dhëniën në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertën e përzgjedhur e procedon te kryetari i komunës për nënshkrim të kontratës me përfituesin, për rastet me periudhë shfrytëzimi afatshkurtër. Për rastet me periudhë të shfrytëzimit afatgjatë ofertën e përzgjedhur e procedon në kuvendin e komunës për aprovim.

4.6 Vendimet në komisionin vlerësues merren me shumicë të votave të anëtarëve të komisionit.

4.7 Komisioni, për punën e tij mbanë procesverbal të cilin e nënshkruan procesmbajtësi dhe kryesuesi i komisionit.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: anëtarët e Komisionit Vlerësues.

6. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës 01 Nr. 54/18 datë 22.02.2018.

7. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

6. Shqyrtimi i Propozim–vendimit për formim të komisionit të ankesave në procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;

Melihate Basholli-Latifi, anëtare e kuvendit-propozoi Nezir Klinakun për anëtar të komisionit të ankesave në procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

Faton Shabani, anëtar i kuvendit – në emër të grupit kuvendar të LVV-së propozoi Hajriz Mustafën për anëtar të komisionit të ankesave në procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

Agim Bregaj, anëtar i kuvendit –propozoi Hysni Gërgurin për anëtar të këtij komisioni.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 19 vota “për” 7 vota “kundër” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim formohet Komisioni për Shqyrtim të Ankesave në procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në këtë përbërje:

- 1.1 Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit;**
- 1.2 Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit;**
- 1.3 Ismet Gashi, ekzekutivi i komunës;**
- 1.4 Burhan Braha, ekzekutivi i komunës;**
- 1.5 Miridon Sadiku, shoqëria civile.**

2. Mandati i komisionit të ankesave është i njëjtë me mandatin e tanishëm të Kuvendit të Komunës.

3. Anëtarët e Komisionit të Ankesave në takimin e parë, me shumicë votash, zgjedhin kryesuesin i cili e kryeson komisionin.

4. Detyrat dhe përgjegjësitet: Komisionit për Anesa shqyrton ankesat brenda dhjetë (10) ditëve kalendarike dhe e njofton Komisionin Vlerësues si dhe palën ankuese lidhur me vendimin sipas ankesës. Vendimet në komisionin e ankesave merren me shumicë të votave të anëtarëve të komisionit. Komisioni, për punën e tij mban procesverbal të cilin e nënshkruan procesmbajtësi dhe kryesuesi i komisionit.

- 5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen anëtarët e komisionit për ankesa.**
- 6. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës 01 Nr. 55/18 datë 22.02.2018.**

7. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

7. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen sociale në Komunën e Vushtrrisë;

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit –tha se kjo informatë sqaron punën e Qendrës për Punë Sociale, ndërsa kjo pikë në plani e punës së kuvendit është paraparë si Informatë për gjendjen sociale në Komunën e Vushtrrisë, andaj këtu sikur kemi devijim përbajtjesorë të kësaj informate me atë se çfarë është dërguar në kuvend. Informimi lidhur me gjendjen sociale të Komunës së Vushtrrisë është një gamë e madhe që inkludon në vete shumë aspekt dhe probleme sociale me të cilat ballafaqohet popullata e Komunës së Vushtrrisë, ndërsa në rastin konkret kemi vetëm përshkrim të kompetencave ligjore të Qendrës për Punës Sociale dhe këtu kemi gabim ose hartuesi nuk e ka kuptuar esencën e kësaj informate, për këtë propozoi që kjo pikë mos të diskutohet fare por në mbledhjen e radhës të procedohet një informatë më e thuktë për gjendje sociale në komunën tonë. **Sylejman Mehollı, drejtor i DSHPS-së**–tha se dihet mirëfilli se Qendrat për Punë Sociale nëpër komunat e Kosovës janë përgjegjëse e kompetente për zbatimin e politikave sociale të cilat janë të dizajnuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, kurse në nivelin lokal nga QPS-të. Në Qendrat për Punë Sociale, kemi dy njësi dhe atë: Njësia e Asistencës Sociale dhe Njësia e Shërbimeve Sociale. Andaj tek NJAS-ja kemi numrin e peronave me asistencë sociale, përkatesisht numrin e kërkesave numrin e aprovimeve dhe refuzimeve, ndërsa tek shërbime sociale kemi shërbimet të cilat ofrohen në kuadër shërbimit social ku bëjnë pjesë: fëmijët pakujdes prindëror, të miturit me sjellje delikuente e të ngashme, por të gjitha këto janë në kompetencë të Qendrës për Punë Sociale. Ndërsa për sa i takon gjendje së mirëqenies sociale drejtoria në fund të kësaj informate ka dhënë statistika se çka në fakt i ka realizuar Drejtoria e Shëndetësisë, ku bëjnë pjesë ndërtimi i 26 shtëpive me bashkëfinancim, ndihma e ndryshme që i kanë ofruar qytetarëve por edhe përmes donacioneve të ndryshme e të ngashme.

8. Shqyrtimi i Draft-Planit Komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar 2019 – 2022 (**shqyrtimi i parë**);

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

- 1. Me këtë vendim jepet në diskutim publik Draft-Plani Komunal për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar 2019-2022.**
- 2. Diskutimi publik fillon nga data 14 janar 2020 dhe zgjat deri më 14 shkurt 2020.**
- 3. Obligohet Zyra për Komunikim me Publikun që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ**

për Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013.

4. Obligohet Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim që si propozues i draft-planit në fjalë të organizojë diskutimin publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) NR. 04/2018 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013. Gjithashtu obligohet zyra e sipërcekur që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantojë kuvendit të komunës në rastin e shqyrimit të dytë të draft-planit në fjalë.

9. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për përkrahjen e fermerëve në bujqësi dhe bizneseve në sektorin privat (shqyrtimi i parë);

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit –tha se do të ishte shumë mirë që aprovimi i kësaj rregulloreje do të ndikonte në etablimin e standardeve për ndarjen e subvacioneve. Kjo është kështu përfaktin se auditori i përgjithshëm ka konstatuar se janë gjetur shkele të kritereve të cilat vetë drejtoria përkatësisht qeveria komunale i ka vendosur. Pastaj ka pasur konstatime se janë vendosur kritere të pamatshme të cilat kritere janë zbatuar nga pjesëmarrësit, ndërsa në fund janë ndarë grantet ashtu siç janë porosit. Në faqen 8 të kësaj rregulloreje ku thuhet: dokumentet e nevojshme për aplikim për subvacione fermerëve kërkohet biznes-plan e nëse këtë e kuptioni kjo është një ngarkesë tepër e madhe për një bujk dhe kjo si e tillë nuk ka logjik, kjo si e tillë mund të kualifikohet si vendosje e barrierave, mandej me bërë përzgjedhje ashtu kush si të dojë. Lidhur me këtë ai është i mendimit që fermeri të prezantoj një planë investiv prej 3 faqesh. Në fund ceku se kjo rregullore do të ketë vështirësi në zbatim përfaktin se më tepër është hartuar në fraza të gjata teorike se sa që është hartuar një rregullore praktike e pragmatike.

Miran Halili, drejtor i DEBPZHR-së–tha se kjo rregullore është vetëm propozim dhe ka mundësi që të plotësohet dhe modifikohet por ajo mëton që të vendos rregulla përdrejtësi dhe objektivitet sa i përket ndarjes së subvacioneve dhe granteve përférmer. Ai vlerësoi më tej se kjo rregullore që njëzet (20) vite i ka munguar Komunës së Vushtrrisë dhe kjo i ka mundësuar qeverisjes së kaluar që të keqpërdor. Neni 20 i kësaj rregullore duhet të hiqet dhe duhet të bëhet lektori i tekstit.

Kushtrim Hyseni, anëtar i kuvendit –vlerësoi se komisionet që i ka themeluar drejtori i Drejtorisë për Ekonomi i ka zhëbë kryetari i komunës dhe ai nuk i ka pyetur fare drejtoret për ndarjen e subvacioneve.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim jepet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Përkrahjen e Fermerëve në Bujqësi dhe Bizneseve në Sektorin Privat.
2. Diskutimi publik fillon nga data 14 janar 2020 dhe zgjat deri më 14 shkurt 2020.
3. Obligohet Zyra për Komunikim me Publikun që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ

për Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013.

4. Obligohet Drejtoria për Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural që si propozues i draft-rregullores në fjalë të organizojë diskutimin publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) NR. 04/2018 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013. Gjithashtu obligohet drejtoria e sipërcekur që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantojë kuvendit të komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të draft-rregullores në fjalë.

10. Shqyrtimi i Raportit të sistemit të menaxhimit të performancës së komunës në ofrimin e shërbimeve për vitin 2018;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi, me vota “unanime” aprovoi Raportin e sistemit të menaxhimit të performancës së komunës në ofrimin e shërbimeve për vitin 2018.

11. Shqyrtimi Projekt-Planit i zhvillimit Institucional të Kujdesit Parësor Shëndetësor 2020-2024;

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – pasi e përgëzoj drejtorin për raportin, shtroj nevojën që në Qendrën Emergjente të shtohet numri i mjekëve për kujdestaritë e natës për shkak se është e pamundur që një mjek ti ofroj shërbime të gjithë atyre pacienteve. Theksoj se është shumë e mbingarkuar ajo qendër.

Faton Shabani anëtar i kuvendit- kërkojë nga drejtori që ti paraqes në pikë të trasha planin për Kujdesin Parësor Shëndetësor.

Mejreme Ismaili anëtare e kuvendit- e përgëzojë drejtorin Sulejman Mehollin për këtë draft-plan kaq mire të hartuar.

Sylejman Meholli, drejtor DSHPS-së- ceku se sa i përket shqetësimit të anëtarit të kuvendit z. Azemit është e vërtet se ballafaqohemi me mungesë të doktorëve dhe kur ai ka ardhur në krye të drejtorisë ka gjetur se shërbimi i urgjencës ka qenë me një (1) doktor ku nuk po i fajësoj ata para meje pse ka qenë ashtu sepse kushtet aq kanë lejuar mirëpo ajo çfarë ne kemi bërë është se në periudhën me kritike të emergjencës ku nga ora 20 deri ne ora 24 kemi ka dy doktor dhe jemi duke bashkëpunuar me Islamik Relief për shtimin e numrit të doktorëve ti bëjmë dy doktor në shërbimin e urgjencës dhe ti bëjmë 5 ditë në javë pune në qendrat familjare nëpër fshatra me numër më të madh të banorëve. Sa i përket planit për kujdesin parësor ne si drejtori kemi dorëzuar një plan afatgjatë katër vjeçar që deri me tanë nuk ka ndodhur dhe aty e kemi sistemuar në mënyrë të detajuar çdo hap si : resurset humane, resurseve infrastrukturore, por edhe për sa i takon shërbimeve shëndetësore cilësinë etj. E falënderoj komitetin drejtues për hartimin të këtij plani që është mjaft voluminoz përmbi 80 faqe ku e kanë vendosur në letër secilin detaj të secilës qendër të mjekësisë familjare. Me këtë plan synohet që të zhvillohet në mënyrë normale shëndetësia kushdo që e qeveris komunën. Në fund falënderoj çdo asamblistë për çdo mbështetje e ofruar për Drejtorinë e Shëndetësisë

Safet Idrizi anëtar i kuvendit- pasi e përgëzoj drejtorin për projekt-planin e kujdesit parësor shëndetësor, kërkojë nga kryesuesi që pikat që janë me rendësi kaq të madhe të vendosen në fillim të pikave të rendit të ditës. Tutje shtoi se lëmi i shëndetësisë por edhe arsimit, duhet ti kushtohet një vëmendje e posaçme. Lidhur me planin vlerësoi se ai është mirë i strukturuar dhe ka sistematizuar çështjet të cila i irregullon, sfidë mbetet implementimi i tij në praktikë, edhe pse kjo

nuk varet krejt nga kuvendi i komunës dhe Drejtoria e Shëndetësisë. Shëndetësia dhe arsimi si fusha bazike të jetës shoqërore të një vendi është dashur të trajtohen me prioritet të lartë nga Qeveria e Republikë së Kosovës, e që fatkeqësish kjo deri me tash nuk ka ndodhur, për shkak të devijimeve që kanë ndodhur në sistemin tonë shëndetësor, ka devijime të mëdha në punësim dhe në ndarjen e specializimeve, dhe tanë ka ardhur gjendja që të mbetemi pa resurse humane dhe kuadro në lëmin e shëndetësisë. Defekti më i madh në këtë lëmi është mungesa e sigurimeve shëndetësore e cila e pamundëson implementimin e konceptit të mjekësisë familjare sepse realizimi i sigurimeve shëndetësore do të reflektonte në rritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore. Sido që të jetë pasi që komuna është përgjegjëse për menaxhimin e ofrimit të shërbimeve të kujdesit parësor shëndetësor, së paku është dashur që kjo pikë të vendoset si pikë e parë e rendit të ditës në këtë mbledhje të kuvendit. Tështo se vitin e kaluar janë kryer një numër i konsiderueshëm i vizitave sistematike shëndetësore nëpër shkollat e komunës, por me keqardhje konstatoi se rekomandimet e nxjerra nga këto vizita nuk janë lexuar në këtë kuvend dhe kanë kaluar ashtu të pa trajtuar, andaj nëse dëshirojmë të jemi serioz dhe të zbatojmë politika të mirëfillta, atëherë duhet të angazhohemi të gjithë së bashku e jo vetëm të qesim gjëra në letra ato të mbesin nëpër sirtar. Sa i përket mbrojtjes parësore shëndetësore, ka vështirësi për shkak se po reduktohet numri i stafit të lartë profesional, kjo përfaktin se momenti i parë që iu jepet mundësia mjekëve tanë ata shkojnë në specializim kështu që kemi numër të vogël të mjekëve familjar ose të specializimit të mjekësisë familjare, sepse pa këta mjekë do të jetë e vështirë të bëhet implementimi i konceptit të mjekësisë familjare, që del nga strategjia kombëtare. Pastaj shtroi nevojën që të përdoren politika përmotivimin e mjekëve familjar, mjekët të cilët punojnë nëpër vendet rurale, kjo përsye se në të kundërtën mjekët tanë do të ikin jashtë vendit. Mandej mjekët tanë si në emergjencë por edhe qendra tjera kanë një numër të madhe të pacienteve që e vështirëson punën e tyre, dhe kjo nuk do të ndodhte nëse do të zbatohet koncepti i mjekësisë familjare. Mungesa e sigurisë nga shtetit përmotivimin e mjekëve familjar, mjekët tanë do të ikin jashtë vendit. Mungesa e sigurisë nga shtetit përmotivimin e mjekëve familjar, mjekët tanë do të ikin jashtë vendit.

Agim Bregaj, anëtar i kuvendit- pasi e vlerësoi lartë hartimin e këtij plani nga ana e drejtorisë e ngritisë çështjen rrëth Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare e cila nuk është aq e mire ku morri si shembull se rastet qe shkojnë në QKUK- janë të papërpunuar fare dhe kërkojë që të futet diagnostika në funksion dhe të kujdestaron një radiolog dhe një teknik laborant. Krejt kjo është përfaktin që të diagnostifikohen sa me mire gjendja e patienteve.

Sylejman Mehollı, drejtor DSHPS-së- tha se sa i përket mbështetjes nuk mundemi ta mohojmë faktin që kemi pasur mbështetje nga qeveria komunale më shumë këto dy vitet e fundit për atë arsy kemi edhe rritje të investimeve në qendra të mjekësive dhe kemi ndarë edhe pagat e para nga kontrata kolektiv. Sa i përket aspektit diagnostikues kemi blerë pajisje të reja në laborator dhe do të futen edhe analiza të reja që nuk janë bërë deri me tanë, kurse sa i preket diagnostikes që i përmendi doktori nuk i kemi në kompetencë dhe menaxhim të kujdesit parësor shëndetësor.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim jepet në diskutim publik Draft-Plani i Zhvillimit Institucional të Kujdesit Parësor Shëndetësor 2020-2024.

2. Diskutimi publik fillon nga data 14 janar 2020 dhe zgjat deri më 14 shkurt 2020.

3. Obligohet Zyra për Komunikim me Publikun që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013.

4. Obligohet Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale që si propozues i draft-planit në fjalë të organizojë diskutimin publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) NR. 04/2018 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013. Gjithashtu obligohet drejtoria e sipërcekur që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantojë kuvendit të komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të draft-planit në fjalë.

12. Të ndryshme;

a). Shqyrtimi i Draft-planit të punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2020;

Nasuf Aliu kryesues i kuvendit- tha se në kuadër të këtij plani parësore është kontributi për parandalimin e aksidenteve në rrugë parandalimi i vjedhjeve, parandalimi i substancave narkotike sidomos në shkolla, masa në eliminim e rrezikut nga qenet endacak dhe është një plan që mendoj se duhet të shqyrtohet me kujdes nga drejtoria gjegjëse sepse është në të mire të qytetarëve.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” aprovoi Planin e Punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2020.

b). Shqyrtimi i Draft-planit për transparencë 2019-2022;

1. Me këtë vendim aprovohet Plani Komunal i Veprimit për Transparencë i Komunës së Vushtrrisë 2019-2022

2. Qëllimi i aprovimit të këtij plani është konsolidimi i infrastrukturës juridike me qëllim të lehtësimit të qasjes së qytetarëve në shërbimet komunale si dhe avancimin e aspektit të rritjes së transparencës në Komunën e Vushtrrisë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Zyra për Informim dhe Komunikim me Publikun, Njësia e Personelit, Zyra e IT-së, Sekretaria e Kuvendi dhe drejtoritë e Komunës së Vushtrrisë.

4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin Plani Komunal i Veprimit për Transparencë në Komunën e Vushtrrisë 2019-2022

c). Shqyrtimi i Draft-Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës së Bizneseve në Komunën e Vushtrrisë; me numër të protokollit 01-272/10 e datës 30.12.2010;

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit- tha se kemi pasur këtë ide që moti për te proceduar këtë pike mirëpo pasi qe erdhi në mënyrë zyrtare nga kryetari i komunës e përkrahim, dhe propozoi që të gjitha bizneseve që gjatë sezonës së dimrit orari i punës të shkurtohet dhe të bëhet deri në ora 22:00 nga ora 23:00 të bëhet 22:00. Pastaj në nenin 6 të kësaj rregulloreje orari i punëve i supermarketeve, vetëshërbimeve dhe dyqaneve ushqimore periudha dimërore përfundimi i orarit të korrigohet nga ora 23:00 në ora 22:00. Në parim e përkrahim këtë iniciativë dhe kërkojmë për implementim nga inspektorati policia e gjykatat ku do te vendoset një rregull i mire për lidhur me funksionimin e gjitha organizatave biznisore të qytetit tonë.

Melihate Basholli, anëtare e kuvendit – kërkojë që fjala bastore të largohet nga rregullorja për shkak sepse lojërat e fatit janë të ndaluara me ligj.

Gresa Muli, anëtare e kuvendit-pasi e përgëzoj drejtoren përpilimin e këtij dokumenti dhe e përkrahi sepse kjo do ta lehtësoje gjendjen e punëtorëve në sektorin privat ku ka shumë punëtor që nuk pushojnë asnje ditë. Propozoj që edhe floktareve tu bëhet një dite pushim pasi ato punojnë të dielave. Për sallonet e ondulimit duhet të bëhet një ditë pushim gjatë ditëve të punës në konsultim me këto biznese duke mos i dëmtuar ato biznese sa i përket klientëve.

Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit- propozojë që biznesi i floktareve gjatë sezonës se verës mos të këtë fare pushim për arsy se është sezona kur ato kanë punë më së shumti dhe këtë e themi pas takimit që ka pasur me to.

Safet Idrizi anëtar, i kuvendit-kërkojë sqarim nga zyra ligjore rrëth punës se bastoreve mos të dërgohet fare në diskutim publik kjo draft-rregullore.

Albanez Tahiraj, zyrtar ligjor- sqaroj se anëtarja në fjalë ka të drejtë dhe se bastoret nuk janë pezulluar por janë ndaluar me ligj veprimtaria e tyre, andaj neni që fletë për bastoret duhet të hiqet nga ky draft. Tutje sqaroi se në diskutim publik shkojnë nenet të cilat propozohen për plotësim-ndryshim.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim jepet në diskutim publik Draft-Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës së Bizneseve në Komunën e Vushtrrisë; me numër të protokollit 01-272/10 e datës 30.12.2010.

2. Diskutimi publik fillon nga data 14 janar 2020 dhe zgjat deri më 14 shkurt 2020.

3. Obligohet Zyra për Komunikim me Publikun që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparency në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparency 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013.

4. Obligohet Drejtoria për Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi. Pylltari dhe Zhvillim Rural që si propozues i draft-rregullores në fjalë të organizojë diskutimin publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) NR. 04/2018 për Transparency në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparency 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013. Gjithashtu obligohet drejtoria e sipërcekur që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantojë kuvendit të komunës në rastin e shqyrimit të dytë të draft-rregullores në fjalë.

5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

ç). Shqyrtimi i memorandumit të mirëkuptimit mes Komunës së Vushtrrisë dhe organizatës Gremin;

Ilmi Azemi anëtar i kuvendit- tha se në parim e përkrahin këtë memorandum mirëpo nuk po janë të sigurt në bazë se cilës procedurë na është ofruar ky memorandum bashkëpunimi a ka pasur thirrje për aplikim apo vetëm ka pasur përgjedhje partizane nëse është kjo e fundit unë nuk e përkrahi . Ne nuk jemi në dijeni se ka pasur ftesë për OJQ për aplikim për ofrimin e një shërbimi në interes të përgjithshme. Ligji në mënyrë decidive e rregullon këtë sferë dhe se nuk mundet paraja publike të shpenzohet në këtë mënyrë dhe çfarëdo vendimi i asamblesë nuk e ligjëson këtë veprim ne nuk e kemi të qartë se kush është propozuesi i këtij propozim-vendimi . kërkoje që të sqarohet procedura se si ka ardhur sepse ne nuk jemi kundër projektit por procedurat duhet të sqarohen.

Albanez Tahiraj, zyrtar ligjor– njoftoi se nuk ka informata për rrjedhjen e procedurave se si ka ardhur deri tek nënshkrimi i këtij memorandum të mirëkuptimit.

Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit – kërkoi paузë që të konsultohen grupet kuvendare së bashku me zyrën ligjore se si të veprohet me këtë pikë.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – kërkoi që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme sepse kjo organizatë nuk është e obliguar ti jap asnjë llogari askujt për mjetet e saj. Pastaj shtoi se kjo çështje nuk mund të votohet në kuvend, por edhe nëse aprovohet vendimi i kuvendit askënd nuk e amniston sepse kjo formë e lindhjes së këtij memorandumi është e kundërligjshme, ngase shpenzimi i parës publike për OJQ, bëhet përmes thirrjes publike.

Melihate Basholli-Latif, anëtar e kuvendit- tha se tek neni 3, pika B është konfuze pasi që në pikën A thuhet që komuna i ka nda mjetet kurse në pikën B thuhet Komuna e Vushtrris do të mbështes dhe përkrah organizatën për gjetjen e fondevë dhe donatorëve potencial për pjesën tjetër të kostos së projektit, andaj nga kjo bënë të kuptohet se organizata nuk i ka mjetet, por komuna do të angazhohet për gjetjen e atyre mjeteteve. Nuk jemi kundër bashkëpunimit dhe OJQ-ve kërkojë që të shtyhet për mbledhjen tjetër që të sqarohet kjo marrëveshje, dhe mbledhje e ardhshme kjo çështje të votohet sipas ligjit.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi që memorandumi i mirëkuptimit mes Komunës së Vushtrrisë dhe organizatës Gremin, të shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

d). Shqyrtimi i Propozim-vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, për ofrimin e shërbimeve me auto-mirimangë;

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatshkurtër e pronës së paluajtshme të Komunës së Vushtrrisë, parcela kadastrale P-70202010-00583-1 me sipërfaqe prej

10057m², ZK Bukosh, në afat prej 5 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për shërbime e transportit të automjeteve me auto-merimangë.

2. Obligohet Komisioni Vlerësues i cili do të formohet nga Kuvendi për këtë vendim-Paraprak, të zhvilloj procedurat për shpaljen e ankandit si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që të bëjë përditësimin dhe mirëmbajtjen e listës, pas përfundimit të procedurave të ankandit dhe menaxhimin e të gjitha kontratave pas lidhjes së tyre.

3. Pjesë e këtij vendimi paraprak janë: certifikata e pronës dhe kopja e planit.

4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

e). Pyetjet e anëtarëve të kuvendit:

Melihate Basholli-Latifi, anëtar e kuvendit- adresoi tri çështje për Drejtorinë e Inspektiveve, e para ligji i duhanit nuk po respektohet sidomos gjate sezonës së dimrit ku frekuentuesit e kafeneve po përballen me këtë dukuri mjafte shqetësuese, pika e dyte: Punëtorët në furra të bukës nuk mbajnë dorëza dhe kjo është një shqetësim për higjienën pika tretë: në shumë lokale ka mungesë të nxehjeve ku punëtorët përballen me të ftotë dhe kushte jo të mira të punës andaj kërkojmë që të merren hapa në këtë drejtim.


Basri Menxhiqi, anëtar i kuvendit- adresoi shqetësim e banorëve të fshatit Bukosh përkatësisht të rrugës "Legjendaret e UÇK-së" të cilën e ka dëmtuar kompania "Bageri" ku këtë rrugë e kanë shfrytëzuar për rregullimin e një rruge në fshatin Liqej për këtë janë parashtruar kërkesa para një viti në Drejtorinë e Inspektiveve ku këta të fundit janë deklaruar se do te rregullohet shumë shpejte dhe ende asgjë nuk është ndërmarrë kurse tani me instalimin e ujësjellësit e kanë bërë prerjen e asfaltit dhe kanë vendosur kubza mirëpo ato kubza kanë hyrë nën sipërfaqen e tokës deri në 10 cm. Sot Drejtori i Drejtorisë së Inspektiveve më tha se kanë dy dite afat për rregullimin e asaj rruge mirëpo nëse nuk rregullohet banorët do të dalin në protesta.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit- pasi i urojë të gjithë përfestat dhe një vite të ri sa më të mbarë, ngriti një shqetësim për punëtorët teknik të shkollave të mesme ku ata punëtor një kohë kanë qenë punëtor të komunës mirëpo me ndryshimin e ligjit ata kanë kaluar tek një kompani private dhe për disa vite nuk u paguhet përvaja e punës. Pra kërkojë që kjo çështje të sqarohet dhe të shikohet se a është e ligjshme që nuk u jepet ajo shtesë. Kjo duhet të sqarohet pasi ka prej këtyre punëtorëve që kanë më tepër se 20 vite përvojë pune dhe nuk iu paguhet kjo shtesë e përvojës së punës.

Nasuf Aliu kryesues i kuvendit- i falënderoi të gjithë për kontributin për gjatë terë vitit 2019 dhe i urojë që viti 2020 të jetë vit i mbarë për të gjithë.


Mbledhja përfundoi në ora 12:15.

Bastri Duraku



Procesmbajtës

Nasuf Aliu



Kryesues i Kuvendit

